



KOSOVO SPECIALIST CHAMBERS
DHOMAT E SPECIALIZUARA TË KOSOVËS
SPECIJALIZOVANA VEÇA KOSOVA

Numri i lëndës: KSC-BC-2020-07

Prokurori kundër Hysni Gucatit dhe Nasim Haradinajt

Vendosi: Trupi Gjykses II

Gjykatës Çarls L. Smith, III, Kryegjykatës

Gjykatës Kristof Barte

Gjykatës Ginel Metro

Gjykatës Fergal Gejnor, Gjykatës Rezervë

Administratore: Fidelma Donlon

Data: 29 shtator 2021

Gjuha: Anglishte

Klasifikimi: Konfidencial

Urdhër për Riklasifikimin dhe Përgjigjet ndaj Transmetimit sipas Rregullës 151

Prokurorit të Specializuar

Xhek Smith

Methju Haling

Valeria Boliçi

Xhejms Pejs

Mbrojtësit të Hysni Gucatit

Xhonatan Elistan Ris

Hju Bauden

Mbrojtësit të Nasim Haradinajt

Tobi Kadman

Karl Bakli



TRUPI GJYKUES II (“Trupi Gjykses”), në përputhje me rregullën 82(5) të Rregullores së Procedurës dhe të Provave para Dhomave të Specializuara të Kosovës (“Rregullorja”), lëshon këtë urdhër.

I. HISTORIKU PROCEDURAL

1. Më 24 shtator 2021, ZPS-ja mori një kërkesë nga Arianit Koci (“z. Koci”) - avokati që ishte lejuar të ishte i pranishëm gjatë intervistës së dëshmitarit W04866 me kërkesë të këtij të fundit - që të ishte përfaqësuesi ligjor i W04866-ës në përputhje me rregullën 151(6) të Rregullores (“Shtojca”).¹
2. Më 27 shtator 2021, ZPS-ja i transmetoi Trupit Gjykses për shqyrtim kërkesën e z. Koci për të përfaqësuar W04866-ën gjatë dëshmisë së tij (“Kërkesa”).²

II. PARASHTRIMET

3. Ndërkohë që përsërit mendimin e saj se nuk ka arsye të besohet se W04866 është përgjegjës për ndonjë vepër penale sipas juridiksionit të Dhomave të Specializuara, ZPS-ja nuk kundërshton që W04866-ës t’i jepen garanci lidhur me vetinkriminimin ose që nga Lista e Mbrojtësve t’i caktohet z. Koci si mbrojtës në kuadrin e dëshmisë së tij të ardhshme.³

III. DISPOZITAT LIGJORE PËRKATËSE

4. Sipas rregullës 82(5) të Rregullores, trupi gjykses mund të riklasifikojë një parashtrim të protokolluar *proprio motu*.

¹ F00327/A01, ZPS, *Shtojca 1 e Transmetimit të Kërkesës sipas Rregullës 151– Email i Arianit Kocit Dërguar ZPS-së (“Shtojca”), 24 shtator 2021, rreptësisht konfidenciale dhe ex parte.*

² F00327, ZPS, *Transmetim i Kërkesës sipas Rregullës 151, me një Shtojcë Rreptësisht Konfidenciale dhe Ex Parte (“Kërkesa”), 27 shtator 2021, rreptësisht konfidenciale dhe ex parte.*

³ Kërkesa, para. 2 që i referohet transkriptit, 8 shtator 2021, f. 692.



IV. DISKUTIM

5. Trupi Gjykses vëren se ZPS-ja i ka dorëzuar Kërkesën dhe Shtojcën si rreptësisht konfidenciale dhe *ex parte*.⁴

6. Duke mbajtur parasysh se: (i) ZPS-ja nuk kundërshton që Kërkesa të riklasifikohet si konfidenciale;⁵ (ii) është në interes të drejtësisë që Mbrojtjes t'i jepet mundësia t'i përgjigjet Kërkesës, nëse dëshiron ta bëjë një gjë të tillë; dhe (iii) Shtojca përmban të dhëna personale të W04866-ës të cilat nuk ka nevojë të nxirren dhe nuk e ndihmojnë Mbrojtjen për t'iu përgjigjur Kërkesës, Trupi Gjykses urdhëron Administratoren ta riklasifikojë si konfidenciale vetëm Kërkesën (F00327). Pas riklasifikimit të Kërkesës, Trupi Gjykses urdhëron Mbrojtjen t'i përgjigjet Kërkesës, nëse dëshiron ta bëjë një gjë të tillë.

V. VENDIM

7. Për arsyet e lartpërmendura, Trupi Gjykses:

- a. **URDHËRON** Administratoren ta riklasifikojë Kërkesën (F00327) si konfidenciale deri më 30 shtator 2021;
- b. **URDHËRON** Mbrojtjen t'i përgjigjet Kërkesës, nëse dëshiron, deri më 6 tetor 2021; dhe
- c. **INFORMON** ZPS-në se nuk do të lejohet të bëjë kundërpërgjigje.

/nënshkrimi/

Gjykatësi Çarls L. Smith, III
Kryegjykatës

E mërkurë, 29 shtator 2021
Hagë, Holandë

⁴Kërkesa, para. 3.

⁵Kërkesa, para. 3.